



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2025

VENDIM

Nr. 635, datë 17.09.2025

**PËR TRANSFERIMIN E PÛRKOHSHËM TË GJYQTARIT
{...} NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM TIRANË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” i ndryshuar, në vendimin nr. 627 datë 17.09.2025 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe duke mbajtur në konsideratë dhënien e pëlqimit të gjyqtarit {...} me postë elektronike, datë 17.09.2025, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 19.09.2025.
3. Gjyqtari {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në gjykatën ku ka caktimin e përhershëm, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.
4. Gjyqtari {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet gjyqësore që ka në gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, çështjet civile që ndodhen në seancë gjyqësore në gjendje

gjykimi ose të pezulluara dhe çështjet penale me të pandehur që ndodhen nën masën e sigurimit "arrest në burg" dhe "arrest në shtëpi" për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor.

5. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
6. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR